



Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, nenit 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., nenit 22 paragrafi 4 i Statutit të Trepça Sh.A, si dhe bazuar në Planin e Biznesit nr.prot.5594 i datës 31.10.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i Trepça Sh.A me datë 01.07.2024 publikon këtë:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës:	Punëtor në Minierë
Koeficienti/Paga	450€ bruto
Nr. i kërkuar	50
Kohëzgjatja e emërimit	Në periudhë të caktuar (1 vjeqare me mundësi vazhdimi)
Data e njoftimit	01/7/2024
Afati për aplikim	02/7/2024-16/7/2024 ora 16:00
Institucioni	Ndërmarrja "Trepça Sh.A."
Njësia Biznesore	Minierat me Flotacion "Trepça"- Stan Tërg
Vendi i punës	Stan Tërg

Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Në mënyrë organizative është i caktuar nëpër të gjitha horizontet punëtor në xehtari dhe ankerim;
- Punon me ndërrime dhe orarin e merr nga mbikëqyrësi i ndërrimit;
- Ndhmon sigurimin e punishtes dhe nihmon procesin e minimumit ose oksidimit të xehes;
- Për punën e tij i përgjigjet xehtarit kryesor në punishtën ku punon, mbikëqyrësit dhe kryepunëtorit;
- Gjatë punës së tij është i obliguar të u përmbahet rregullave teknike të mbrojtjes në punë;
- Ndhmon xehtarin kryesor në bartjen e eksplozivit nga depoja e horizontit deri në punishte;
- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e tij/saj;
- Punon punë dhe detyra tjera në horizontet dhe punishtet që kontribon në rrjetin e prodhimit dhe produktivitetit në minierë që i cakton mbikëqyrësi.

Kriteret e përgjithshme

a) Arsimimi i kërkuar:

- Minimumi Diplomën e Shkollës së mesme të ulët

b) Përvoja e punës e kërkuar:

- Përparësi kanë aplikantët që kanë përvojë pune në Minierë ose punë praktike së paku 6 muaj.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Dëshminë e përvojës së punës ose praktikës së punës në minierë;
- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për vepër penale jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- CV-Biografia;
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës.

Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më 23/07/2024, në ueb faqen e ndërmarrjes “Trepça Sh.A.” (<https://trepcasha.com/>).

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim- 70%
- Intervista – 20%
- CV- 10%

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.”

Mënyra e aplikimit

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet përmes e-mailit: burimenjerezore@trepcasha.com duke theksuar në “subject” titullin e pozitës për të cilën aplikoni.

Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.” dhe do të njoftohet edhe në mënyrë elektronike. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

